



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2022:046151
Datë: 13.12.2023
Numri i dokumentit: 05061198

C.nr.159/2022

Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.H, nga Komuna e Deçanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.K, avokat në Pejë, kundër të paditurës Komunes së Deçanit, Drejtoria e Arsimit, me seli në Deçan, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve ushqimore, me vlerë të kontestit 1.000,00 €, jashtë seance më datë 12 dhjetor 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.159/2022, e datës 09.03.2022 e paditëses L.H, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, lidhur me çështjen e kompensimit të shpenzimeve ushqimore.

A r s y e t i m

Paditësja L.H, nga Komuna e Deçanit, përmes përfaqësuesit me autorizim ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, për kompensim e shpenzimeve ushqimore.

I autorizuari i paditëses me parashtresën e datës 11 dhjetor 2023, e kanë njoftuar gjykatën se për arsye se është dorëzuar dy herë e njëjta padi për kontestin e njëjtë, e tërheq padinë ndaj të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë të kontestit kompensim i shpenzimeve ushqimore.

Gjykata e vlerësoj faktin nëse në këtë gjykatë janë të ushtruar dy padi për të njëjtën çështje dhe gjeti se qëndron fakti i tillë ngase në këtë gjykatë me datë 13.02.2020 është pranuar padia e cila evidentohet sipas numrit C.nr.67/20 dhe numër të dosjes në SMIL 2020:022446, e cila padi po ashtu është parashtruar nga paditësja e njëjtë, ndaj të paditurit të njëjtë dhe ka të njëjtën çështje

për objekt të kontestit, andaj gjykata veprimi në raport me parashtrësën e paraqitur dhe konstatoi se padia është tërhequr.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.159/2022, datë 12.12.2023

Gjyqtari

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.